



Projekti „ALLE”

Informacion për prindër

Identifikimi i pikave të forta, shfrytëzimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre

Shkolla sekundare ka për qëllim, të përgatisë të gjithë të rinjtë mundësisht në mënyrën më optimale për kalimin në një trajnim profesional ose në një shkollë të lartë. Aftësitë në lëndët gjermanisht dhe matematikë në këtë rast kanë një rëndësi qendrore. Një krahasim me vendet tjera evropiane tregon, se të rinjtë në Zvicër dhe në kantonin e Cyrihut pas nëntë vitesh shkollë për fat të mirë e kapërcejnë mesataren në lexim dhe në matematikë. Por rezultatet tregojnë njëkohësisht, se jo të gjithë nxënëset dhe nxënësit ia dalin të përvetësojnë bazat e nevojshme gjuhësore dhe matematikore deri në fund të shkollës fillore të detyrueshme për në jetën e tyre të mëtejshme në trajnim dhe profesion. Në bazë të kësaj drejtoria arsimore së bashku me shkolla të ndryshme sekundare merr masa në konsideratë, të cilat përkrahin dhe nxisin në mënyrë të përqendruar para së gjithash nxënëset dhe nxënësit me rezultate më të ulëta në mësim.

Projekti „ALLE”

Për suksesin në mësim kanë një ndikim të rëndësishëm nga njëra anë kualiteti i mësimit dhe nga ana tjetër motivimi për të mësuar nga secili prej nxënëseve dhe nxënësve. Në projektin pilot „Kohë aktive për të mësuar dhe sukses në të mësuar për TË GJITHË”/ «Aktive Lernzeit und Lernerfolg für ALLE» merren masa në provë, të cilat duhet ti mundësojnë të gjithë nxënëseve dhe nxënësve, të rrisin aftësitë mësimore në lëndët matematikë dhe gjermanisht. Qëllimi është, që të rinjtë të përmirësojnë me anë të situatave të përshtatshme mësimore bazat që mungojnë dhe nëpërmjet këtyre të jenë të mirëpërgatitur për trajnimin profesional dhe shkollat e tjera të larta.

Shkollat sekundare të përfshira në projekt promovojnë dhe u parashirojnë kërkesa nxënëseve dhe nxënësve me rezultate më të ulëta mësimore me anë të masave të mëposhtme:

Kompetencat themelore në gjermanisht dhe matematikë

Shfrytëzimi efektiv i kohës së mësimit në matematikë dhe gjermanisht

Në matematikë nxënëset dhe nxënësit mbështeten në ato përbërës lënde, të cilët janë të rëndësishëm për integrimin e tyre në profesion. Ata përqendrohen plotësisht në lëndën mësimore bazë dhe u jepet kështu kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe përsëritje. Në mësimin e gjermanishtes nxënëset dhe nxënësit më të dobët marrin një trajnim special leximi dhe shkrimi.

Mjete speciale mësimi

Mjetet mësimore të shkollës sekundare bazohen mbi njohuritë paraprake të shkollës primare pa iu përkushtuar atyre në mënyrë speciale. Nëse nxënëset dhe nxënësit shfaqin mangësi në materialin mësimor, atëherë ata mundën pjesërisht ose nuk mundën të përmbushin kërkesat e shkollës sekundare. Prandaj është e rëndësishme, që me këta të rinj të përmirësohen bazat mësimore që mungojnë me anë të mjeteve mësimore të përshtatshme.

Më shumë kohë mësimi dhe orë shoqëruese detyrash

Nxënëset dhe nxënësit me rezultate të ulëta mësimore kanë shpesh vështirësi ti bëjnë detyrat në mënyrë të pavarur. Prandaj është futur në mënyrë të obligueshme në projektin ALLE ndihma për detyrat dhe me anë të kësaj është rritur edhe koha individuale e mësimi. Kjo ofertë shërben së pari në punimin e detyrave në gjermanisht dhe matematikë. Këtu fokusi vihet mbi teknikat përkatëse të punimit dhe mësimi. Oraret e detyrave fiksohen në një plan orësh dhe lihen në përkujdesjen e një mësuesi. Mundësisht të gjithë nxënëset dhe nxënësit duhet ta përdorin atë.

Shërbimi i asistentëve të klasave

Në projektin ALLE mbështetja dhe shoqërimi i nxënësve dhe nxënësve intensifikohet me ndihmën e asistentëve të klasave. Në sajë të asistentit, mësuesët mundën nga njëra anë, ti përkushtohen njohurive paraprake dhe nevojave mësimore të nxënësve dhe nxënësve në mënyrë më individuale. Nga ana tjetër asistentët kujdesen për secilin prej nxënësve dhe nxënësve në bashkëpunim dhe marrëveshje me mësuesit. Për tu vënë re është, që nuk është parashikuar, që asistentët të marrin përsipër përgjegjësinë për përkrahjen specifike të secilit fëmijë.

Fuqizimi i motivimit shkollor

Ç'farë do të thotë „ALLE” për vajzën time/djalin tim?

Në projektin ALLE përfshihen rreth dhjetë shkolla, në mes tyre edhe shkolla sekundare e vajzës Tuaj/ djalit Tuaj. Projekti ka për qëllim, që mundësisht të gjithë nxënëset dhe nxënësit të përvetësojnë kompetencat bazë në gjermanisht dhe matematikë. Edhe pse vëmendja bie mbi nxënëset dhe nxënësit me rezultate të dobëta, të gjithë duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga masat e marra. Në një mësim, tek i cili përqendrimi bie mbi premisat apo kushtet individuale mësimore, u parashtrohen kërkesa dhe motivohen edhe fëmijët me aftësi të veçanta bazuar mbi nivelin e kompetencave të tyre. Pra qëllimi është, të ndihmohen si nxënëset dhe nxënësit e dobët ashtu edhe ata të përparuar në sajë të nevojave të tyre mësimore.

Nëse rrezikohet arritja e kompetencave bazë në gjermanisht dhe/ose matematikë, atëherë personeli përkatës mësimdhënës mund të reduktojë lëndën mësimore në



takimin me prindërit e nxënësve dhe nxënësve të prekur, mund të vendosin qëllime individuale mësimi si dhe të zgjedhin për këto qëllime situata të përshtatshme mësimi.

Për këtë personeli mësimdhënës aftësohet në mënyrë speciale në shumë kurse kualifikimi, për ti ndihmuar të rinjtë në mënyrë më efektive në rrugën e tyre të të mësuarit, për ti dhënë atyre në vazhdimësi feedback mbi përparimet e tyre në mësim dhe për ti motivuar kështu për të mësuar. Ky është qëllimi i deklaruar i projektit ALLE, në mënyrë që të mund të përfitojnë të gjithë nxënëset dhe nxënësit.

Shtypi

Botues:
Bildungsdirektion Kanton Zürich
Volksschulamt

Shtator 2015